

Mentor HASANI

KRIMET E FORCAVE SERBE NË KOMUNËN E LIPJANIT (1998-1999)

Ky hulumtim, synon të paraqes një pasqyrë reale të krimeve të luftës në komunën e Lipjanit. Gjatë realizimit të këtij punimi, është bërë përpjekje dhe është parë me shumë rëndësi, sjellja e të dhënave të mirargumentuara, në lidhje me dokumentimin e një numri krimesh e masakrash të kryera nga forcat serbe në periudhën e luftës së vitit 1998/99. Edhe Lipjani, sikurse shumica e qyteteve të asaj periudhe në Kosovë, ka pësuar dëme të mëdha si në njerëz, po ashtu edhe dëme materiale. Ky tekst merr në shqyrtim një sërë materialesh, raportesh, statistikash e analizash në të cilat paraqiten krimet e forcave serbe në komunën e Lipjanit me rrethinë.

Burimet e përdorura për realizimin e këtij punimi, na ofrojnë të dhëna të vlefshme në të cilat janë të paraqitura në mënyrë të detajuar aksionet ndëshkuese të forcave serbe që për qëllim kishin zbatimin e projektit hegjemonist serb, të njohur me emrin “toka e djegur”. Zbatimi i këtij projekti rezultoi me vrasjen e 167 banorëve civilë të komunës së Lipjanit. Nga 167 të vrarët*, 32 persona të gjinisë femërore dhe 135 të tjerë të gjinisë mashkullore. Shumica e të vrarëve ishin nga komuna e Lipjanit (153 persona), ndërsa 15 të tjerë ishin nga komunat e afërta, por që në kohën e ofensivave ishin të strehuar në trevën e Lipjanit. Edhe sipas të dhënave nga Ismail Gashi-Silovia gjatë dy ofensivave korrik-tetor 1998 dhe mars-qershor 1999**, u vranë 167 civilë, ndërsa janë plagosur 71 qytetarë të tjerë. Por, sa i përket numrit të civilëve të vrarë në këtë komunë ka të dhëna të ndryshme. Kështu, sipas burimeve të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ), në komunën e Lipjanit janë vrarë 160 persona civilë shqiptarë (124 meshkuj dhe 36 femra). Të dhënat e siguruara

* Informacionet e siguruara nga burimet e shfrytëzuara në këtë punim dëshmojnë se këto vrasje kanë ndodhur gjatë dy ofensivave, në verën e vitit 1998 dhe pranverën e vitit 1999.

** Në lidhje me këto statistika dhe të dhëna të tjera të kësaj periudhe, sa u përket vrasjeve, masakrave dhe shkatërtimeve të kudo ndodhura nga forcat serbe, shih edhe: Xhemajl Berisha, *Zhvillimet politike-sociale në Lipjan gjatë viteve 1997-1999*, (Tezë masteri), (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2018), 39.

nga ky burim, identifikojnë se prej të vrarëve 19 janë fëmijë nën moshën 19-vjeçare^{***}, 105 persona janë të moshës 19 deri 60-vjeçare, 34 persona mbi moshën 60-vjeçare, kurse për dy persona nuk ka të dhëna.¹ Ndërsa sa i përket numrit të personave të zhdukur, shifrat flasin për 8 persona, 7 meshkuj dhe 1 femër. Kur jemi te shifrat, në jo pak raste janë hasur të dhëna që kanë shpërputhje mes vete, gjë e cila kërkon një studim edhe më të stërholluar dhe definitiv të këtyre krimeve dhe statistikave.

Në frymën e kësaj, shifrat që ofrohen nga studiuesi Hakif Bajrami, janë shifra më të larta, sipas të cilave në këtë komunë janë vrarë 190 civilë, ndërsa të zhdukur janë 22 civilë dhe të plagosur 312 civilë.² Shifër të përafërt të të vrarëve dhe të të plagosurve hasim edhe në burime të tjera, sipas të cilave nga ekspeditat serbe, granatimet, torturat, sulmet dhe masakrat, në komunën e Lipjanit janë vrarë 184 civilë dhe mbi 312 janë plagosur.³ Numrin e njëjtë të të plagosurve (312) dhe të zhdukurve (22) e jep edhe aktivisti Shefki Ukaj, por sa u përket të vrarëve ai thotë se në këtë komunë gjatë viteve të luftës 1998/99 forcat serbe kanë vrarë dhe masakruar 209 qytetarë shqiptarë, prej të cilëve 19 janë dëshmorë, ndërsa 190 civilë.⁴ Sa u përket dëmeve materiale nga 69 fshatra të kësaj komune, 46 prej tyre janë përfshirë nga sulmet e forcave serbe, ku shkatërrim të tërësishëm kanë pësuar 1 279 objekte-shtëpi banimi, e pjesërisht janë dëmtuar 456 të tjera.* Gjithashtu, të dhënat flasin për shkatërrimin e 4 objekteve shkollore dhe një objekti shtëpi-shkollë, pronë e Hilmi Krasniqit në Lipjan. Pos shkatërrimeve dhe demolimeve të përgjithshme, forcat serbe në këtë komunë realizuan edhe plaçkitjen e një numri prej 43 objektesh shkollore. Po ashtu u demoluan 1 822 shtëpi shqiptare dhe objekte me destinim tjetër. Nga

*** Sipas studiuesit Nusret Pllana, numri i fëmijëve të vrarë dhe të ekzekutuar në këtë komunë është 29, prej të cilëve 11 janë vajza dhe 18 djem. Listën e fëmijëve të ekzekutuar nga forcat serbe në komunën e Lipjanit me të dhëna të plota mund ta gjeni në: Nusret Pllana, *Terrori i Serbisë pushtuese mbi shqiptarët, 1844-1999*, Prishtinë: Arkivi Shtetëror i Kosovës, 2013, 545-546.

¹ *Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999*, Monografi I, Prishtinë: Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNI), 2010, 911.

² Hakif Bajrami, *Lufta kundër luftës në Kosovë*, në: “Kosova shtet i pavarur dhe sovran”, Prishtinë: Instituti i Historisë Bashkëkohore, 2006, 170.

³ Sefer Tasholli, *Lipjani me rrethinë, Monografi*, Prishtinë: Prokult Press, 2020, 322.

⁴ Shefki Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lipjanit, 1912-1999*, Prishtinë: Faik Konica, 2004, 16 dhe 96. Listën e civilëve të vrarë në komunën e Lipjanit mund ta gjeni në këtë vepër në faqet 97-100.

* Një burim tjetër thotë se në 72 fshatrat e komunës së Lipjanit, nga ushtria dhe policia serbe janë djegur dhe granatuar 1 792 shtëpi, ndërkaq 1 311 janë shkatërruar tërësisht. Shih në: Shefki Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lipjanit, 1912-1999*, Prishtinë: Faik Konica, 2004, 15.

shkatërrimi, nuk kanë shpëtuar as ndërmarrjet shoqërore, me ç'rast evidencohen të shkatërruara që të gjitha, duke përfshirë, fabrikat dhe njësitë ekonomike të kooperativës bujqësore, pastaj 2 zyre të vendit, 2 xhami, 1 ambulancë dhe shumë objekte afariste, zejtare etj.⁵ Edhe sa u përket dëmeve materiale në Lipjan ka të dhëna të ndryshme. Kështu, sipas studiuesit Hakif Bajrami, në këtë komunë janë djegur dhe shkatërruar 63 fshatra, 1 792 shtëpi, 1 472 objekte dhe 13 shkolla, që në total, përkthyer në të holla, dëmet materiale kapin shifrën prej 154 798 243 dollarë.⁶

Për t'u rikthyer edhe njëherë tek çështja më esenciale sa u përket krimeve, duhet vënë në pah se krimet më masive në komunën e Lipjanit, janë kryer gjatë vitit 1999, mirëpo në këtë komunë një vit më parë, pra më 1998 janë ekzekutuar në forma dhe vende të ndryshme 22 qytetarë civilë shqiptarë. Në mënyrë tabelore do të japim të dhëna të detajuara për të ekzekutuarit civilë shqiptarë, të cilët pësuan nga sulmi i ndërmarrë nga forcat serbe në vitin 1998:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Data e vrasjes	Mosha	Gjinia
1.	Rashit Cani	Baicë	25 gusht 1998	42	Mashkull
2.	Veli Bylykbashi	Baicë	15 shtator 1998	42	Mashkull
3.	Murat Cani	Baicë	/	/	Mashkull
4.	Sahit Brestovci	Breg i Zi	26 korrik 1998	55	Mashkull
5.	Afërdita Qiriqi	Krojmir	31 korrik 1998	23	Femër

⁵ Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë, 1998-1999*, 1, Prishtinë: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, 2012, 501-502; *Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999*, 906.

⁶ Sipas Xhemajl Berishës, i cili i referohet studiuesit Jusuf Osmani, në veprën "Vendbanimet e Kosovës - Lipjani", vlera e përgjithshme e dëmtimeve material, shpirtërore kap shumën e përafërt prej 78 000 000 €, shih në: Xhemajl Berisha, *Zhvillimet politike-sociale në Lipjan gjatë viteve 199-1999*, (Tezë masteri), (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2018), 31.

6.	Emine Olluri	Krojmir	27 gusht 1998	29	Femër
7.	Isa Olluri	Krojmir	14 dhjetor 1998	19	Mashkull
8.	Elmije Zeneli	Mirenë	13 gusht 1998	17	Femër
9.	Emine Zeneli	Mirenë	13 gusht 1998	9	Femër
10.	Veli Olluri	Krojmir	28 shtator 1998	42	Mashkull
11.	Blerim Osmani	Rusinoc	31 gusht 1998	/	Mashkull
12.	Fadil Sinani	Rusinoc	31 gusht 1998	35	Mashkull
13.	Fatime Sinani	Rusinoc	2 shtator 1998	60	Femër
14.	Ganimete Sinani	Rusinoc	31 gusht 1998	28	Femër
15.	Donikë Morina	Shalë	11 tetor 1998	/	Femër
16.	Haki Qeriqi	Shalë	31 korrik 1998	/	Mashkull
17.	Haxhi Karpuzi	Shalë	31 korrik 1998	47	Mashkull
18.	Rabije Mulaku	Shalë	26 korrik 1998	43	Femër

19.	Vehbi Shamolli	Shalë	28 gusht 1998	75	Mashkull
20.	Habib Vuniqi	Vërshec	26 korrik 1998	17	Mashkull
21.	Muharrem Çadraku	Vërshec	25 gusht 1998	55	Mashkull
22.	Tefik Vuniqi	Vërshec	18 korrik 1998	17	Mashkull ⁷

Nga të dhënat e mësipërme del se, nga 22 civilët e vrarë shqiptarë më 1998, për nga mosha e të ekzekutuarve ka fëmijë 9 vjeç dhe pleq deri në moshën 75-vjeçare, ndërsa sa i përket aspektit gjinor, nga 22 civilët e vrarë 8 janë të gjinisë femërore, ndërsa 14 të gjinisë mashkullore. Duhet theksuar faktin se krimet më të mëdha edhe në këtë komunë si në tërë Kosovën janë kryer gjatë vitit 1999. Në komunën e Lipjanit gjatë këtij viti janë kryer këto masakra:

Emri i masakrës	Periudha e ekzekutimit	Numri i viktimave
1. Masakra e Sllavisë	15/16 prill 1999	41 viktima
2. Masakra e Ribarit të Vogël	18 prill 1999	25 viktima
3. Masakra e Hallaqit	19 prill 1999	20 viktima
		Gjithsej: 86 viktima

Krahas ushtrisë dhe policisë serbe, në këtë komunë krime ndaj popullsisë civile shqiptare ka kryer edhe njësi special i themeluar nga Beogradi zyrtar, në përbërje të policëve dhe të ekstremistëve serbë. Këtë formacion e udhëhiqte polici serb që njihej me nofkën “Bokser”.⁸

⁷ Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lypjanit*, 92.

⁸ *Po aty*, 16.

Masakra e Sllovisë

Fshati Sllovi i komunës së Lipjanit në periudhën e bombardimeve të NATO-s u shndërrua në bazë të formacioneve ushtarake dhe policore serbe. Sipas dëshmitarëve, më 14 prill 1999, një ditë para sulmit, në ora 10:00 paradite kishte arritur në këtë fshat inspektori i sigurimit serb, Çanoviqi, me dy eprorë ushtarakë dhe në vendin e quajtur “Kryezabeli” kishte takuar Shefqet Berishën nga Sllovia, nga i cili kishte kërkuar që shqiptarët e këtij fshati deri në orën 14:00 t’i dorëzonin të gjitha armët te shkolla e vjetër.

Gjatë mbrëmjes, serbët vendas kërkuar një takim me shqiptarët, për një “marrëveshje sigurie” që do të arrihej më 15 prill 1999, me një oficer të armatës serbe dhe me struktura udhëheqëse serbe të fshatit. Oficeri, përkundër premtimeve, nuk shkoi në takimin e mëngjesit të 15 prillit. “Takimi” ishte një mashtrim që strukturat qeveritare e policore serbe e bënë në vazhdimësi. Më 15 prill 1999, nga ora 05:30 të mëngjesit forcat serbe me 5-6 tanke nga ana e Smallushës u pozicionuan në kodrën e fshatit Sllovi, kurse në orën 06:00 filloi sulmi ndaj fshatit Akllap, ku e vranë një qytetar civil shqiptar, (Ibush Gashin 70-vjeçar), dëbuan popullatën shqiptare dhe dogjën pjesën dërmuese të shtëpive. Rreth orës 14:00 ushtria dhe policia serbe filloi sulmin mbi fshatin Sllovi nga dy drejtime: nga krahu i Akllapit dhe nga krahu i fshatit Gushtericë e Epërme. Forcat serbe të mbështetura nga serbët lokalë ishin pozicionuar në të gjitha udhëkryqet dhe hyrje-daljet e fshatit.⁹

Këtyre forcave u printe kryeshefi i stacionit të policisë në Lipjan, Nikolla Iliqi, zv.komandanti, Nikolla Toshiq dhe inspektori i sigurimit Çanoviqi, të ndihmuar edhe nga serbët e armatosur të fshatit si: Tomisllav Stanishiq (Tomçi), komandanti lokal i policisë rezervë për Sllovi, Milivoje Peiqi, Radomir Arsiqi (Rada) kryetar i fshatit, Stanoje Millkiqi (Çausi) Sllobodan Simiqi (Duçi), Lubisha Arsenije Periqi, Dragisha Pejqi etj.¹⁰ Kështu, më 15 prill në këtë fshat u ekzekutuan 24 civilë shqiptarë, fshatarë të moshave të ndryshme dhe të të dy gjinive, u dëbuan të gjithë qytetarët shqiptarë të fshatit, ndërsa nga forcat ushtarake dhe policore serbe u dogjën 63 shtëpi. Gjashtëmbëdhjetë (16) qytetarë të tjerë të vranë më 15 prill 1999 i kanë varrosur vetë serbët me ndihmën e romëve të NSH “Vëllaznimi”, në dy varreza masive jashtë fshatit, në vendin e quajtur “Quka”. Më 29 prill nga forcat serbe janë zhvarrosur të 16 kufomat dhe janë sjellë në shkollën e

⁹ Ruzhdi Jashari, Ali Uka, “Masakra e Sllovisë (15-16 prill 1999)”, Fjalori Enciklopedik i Kosovës, Volumi II, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2018, 1060.

¹⁰ Tasholli, *Lipjani me rrethinë*, 323; Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lipjanit*, 63.

vjetër, ndërsa më 30 prill 1999 nën kërcënimin e armëve janë detyruar disa shqiptarë të kryejnë rivarrimin e tyre në varrezat e fshatit. Kurse sa u përket tre personave të tjerë të pajetë: Adem Bytyçi, Gafurr Hyseni dhe Ajvaz Gashi, ata i kanë varrosur në fshehtësi familjarët e tyre.

Një ditë më pas, konkretisht më 16 prill 1999 në vendin e quajtur te “Lugu i Demës”, forcat ushtarake e policore serbe së pari plaçkitën e më pasë i ekzekutuan edhe 17 qytetarë shqiptarë (16 burra dhe një grua) të moshave të ndryshme. Po ashtu janë plagosur edhe 12 civilë të tjerë shqiptarë. Ekzekutimet e viktimave janë bërë në prezencë të familjarëve të tyre, me armë zjarri dhe me therje dhe prerje gjymtyrësh. Kufomat e tyre janë zhvarrosur dhe më pas me qëllim të zhdukjes së krimit, i kanë dërguar në varrezat masive në Batajnicë të Serbisë, ku kanë qëndruar deri më 15 prill 2006, kur edhe u sollën 15 mbetje mortore, me përjashtim të mbetjeve mortore të Halime Gërbeshit, mbetjet mortore të së cilës u rivarrosën më 2018. Autopsitë e kufomave të të vrarëve janë kryer nga hetuesit e Tribunalit të Hagës.¹¹ Në këtë masakër, ndër familjet që kanë humbur më së shumti anëtarë janë familja Gashi 6 anëtarë, familja Gërbeshi 5 anëtarë etj.¹² Po ashtu, në Sllovi janë mbytur me tortura fizike edhe 5 shqiptarë të tjerë.¹³

Sipas dëshmitarëve që kanë arritur t’u shpëtojnë krimeve të forcave serbe, të gjithë të ekzekutuarit ishin civilë dhe të paarmatosur, të cilët u vranë nëpër shtëpitë dhe pranë familjeve të tyre. Kështu, dëshmitarja Zejnepe Gashi, ndër të tjera ka dëshmuar se: “*kriminelët serbë, pasi na nxorën nga shtëpia, na thanë: a doni t’ua djegim shtëpinë apo t’ua vrasim djemtë?... Njëri nga këta paramilitarë më kapi për krahu dhe më largoi prej djemve për disa metra, duke më grushtuar në prani të tyre tri-katër herë. Më pas na urdhëruan të dilnim në rrugë dhe sapo dolëm filluan të shtënat e njëpasnjëshme nga të gjitha llojet e armëve, kur edhe mu vranë dy djemtë, burri dhe dy nipa*”.¹⁴

¹¹ Jashari, & Uka, “*Masakra e Sllovisë (15-16 prill 1999)*”, 1060.

¹² Muhamet Shatri, *Recension për veprën: Shefki Ukaj, Krimet serbe në komunën e Lipjanit (1912-1999)*, Prishtinë: Faik Konica, 2004, në Kosova, Nr. 24/25, 345-348.

¹³ Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë, 1998-1999*, 502; *Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999*, 909.

¹⁴ Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lypjanit*, 68-69.

Lista e emrave të civilëve të vrarë në masakrën e Sllovisë, më 15 dhe 16 prill 1999

Nr.	Emri dhe mbiemri	Viti i lindjes	Vendlindja	Gjinia	Mosha e viktimës
1.	Murat Nebih Gashi	1934	Sllovi	Mashkull	65-vjetar
2.	Enver Murat Gashi	1958	Sllovi	Mashkull	41-vjetar
3.	Omer Murat Gashi	1964	Sllovi	Mashkull	35-vjeçar
4.	Arben Enver Gashi	1982	Sllovi	Mashkull	17-vjeçar
5.	Bekim Jakup Haziri	1978	Prishtinë	Mashkull	21-vjeçar
6.	Bajram Qazim Gashi	1965	Sllovi	Mashkull	34-vjeçar
7.	Mehdi Xhemajl Pacolli	1937	Sllovi	Mashkull	62-vjeçar
8.	Ramadan Halil Kryeziu	1969	Sllovi	Mashkull	30-vjeçar
9.	Jakup Elmaz Kryeziu	1953	Sllovi	Mashkull	46-vjeçar
10.	Elmi Xhevat Berisha	1964	Sllovi	Mashkull	35-vjeçar
11.	Rifat Zenel Gashi	1953	Sllovi	Mashkull	46-vjeçar
12.	Milaim Musli Gashi	1977	Sllovi	Mashkull	22-vjeçar
13.	Adem Rrahman	1940	Sllovi	Mashkull	59-vjeçar

	Bytyqi				
14.	Gafurr Qazim Hyseni	1948	Sllovi	Mashkull	51-vjeçar
15.	Sheride B. Sopa	1912	Sllovi	Femër	87-vjeçare
16.	Mehmet Hazir Sopa	1926	Sllovi	Mashkull	73-vjeçar
17.	Qamile Shaban Sopa	1936	Sllovi	Femër	63-vjeçare
18.	Hajdie Krasniqi	1945	Sllovi	Femër	54-vjeçare
19.	Fatushe Fetah Dubova	1980	Sllovi	Femër	19-vjeçare
20.	Agim Rrahim Berisha	1969	Sllovi	Mashkull	30-vjeçar
21.	Florim Rizah Ibrahim	1974	Sllovi	Mashkull	25-vjeçar
22.	Faik Hysen Krasniqi	1964	Sllovi	Mashkull	35-vjeçar
23.	Ajvaz Qazim Gashi	1937	Sllovi	Mashkull	62-vjeçar
24.	Balik Feriz Gërbeshi	1925	Sllovi	Mashkull	74-vjeçar
25.	Shaip Balik Gërbeshi	1961	Sllovi	Mashkull	38-vjeçar
26.	Faik Balik Gërbeshi	1965	Sllovi	Mashkull	34-vjeçar
27.	Bejtush Sali Gërbeshi	1967	Sllovi	Mashkull	32-vjeçar
28.	Halime Shaban Gërbeshi	1913	Sllovi	Femër	86-vjeçare

29.	Jonuz Hamdi Pacolli	1942	Sllovi	Mashkull	57-vjeçar
30.	Fatmir Shefki Bytyqi	1963	Sllovi	Mashkull	36-vjeçar
31.	Hasan Shefki Bytyqi	1981	Sllovi	Mashkull	18-vjeçar
32.	Isak Zejnë Bytyqi	1957	Sllovi	Mashkull	42-vjeçar
33.	Avni Misin Sopa	1979	Sllovi	Mashkull	20-vjeçar
34.	Ramadan Azem Sopa	1973	Sllovi	Mashkull	26-vjeçar
35.	Zeqir Hamdi Hetemi	1979	Sllovi	Mashkull	20-vjeçar
36.	Naser Rexhep Ismajli	1981	Sllovi	Mashkull	18-vjeçar
37.	Haki Hasan Ismajli	1979	Sllovi	Mashkull	20-vjeçar
38.	Raif Maliq Shala	1948	Shushicë	Mashkull	51-vjeçar
39.	Heset Ilaz Lekiqi	1967	Gadime e Ulët	Mashkull	32-vjeçar
40.	Hava B. Pacolli	1946	Sllovi	Femër	53-vjeçare
41.	Latife Haqif Kryeziu	1952	Sllovi	Femër	47-vjeçare*

Në këtë fshat, përtej kësaj liste, llogariten të jenë edhe katër viktime civile, që kanë vdekur më pas në rrethana të tjera, si Shefki F. Salihu, i cili pas rrahjes me dru e cila ndodhi më 3 maj, si pasojë e dhunës dhe brutalitetit

* Jashari, & Uka, “Masakra e Sllovisë (15-16 prill 1999)”, 1060; Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lypjanit*, 97-100.

të ushtruar mbi të, një muaj më pas ka vdekur, konkretisht më 3 qershor 1999. Pastaj tre qytetarë civilë të këtij fshati gjatë muajit qershor 1999 gjetën vdekjen pasi ranë në mina të vendosura nga forcat serbe: Ibrahim R. Beqiri (14 qershor 1999), Shaban H. Berisha dhe Nehat Sh. Berisha (12 qershor 1999).¹⁵ Si përfundim mund të themi se në masakrën e Slllovisë më 15 dhe 16 prill 1999, nga forcat ushtarake dhe policore serbe u vranë e u masakruan 41 qytetarë shqiptarë, ndërsa janë plagosur 12 të tjerë. Sa i përket strukturës gjinore raporti është 7 viktime të gjinisë femërore dhe 38 të gjinisë mashkullore. Moshë e viktimave është nga 17 deri në 87 vjeçar. Përveç vrasjes e dhunës së ushtruar fizike, vërehet se shumë e theksuar ka qenë edhe dhuna psikike, pasojat e së cilës janë shfaqur në vitet e mëpastajme.

Masakra e Ribarit të Vogël

Më 18 prill 1999 në fshatin Ribar i Vogël të komunës së Lipjanit në orët e hershme të mëngjesit, grupe të mëdha forcash ushtarake e policore serbe të ndihmuara edhe nga serbët lokalë, nga të gjitha anët hynë në këtë fshat dhe e filluan aksionin e plaçkitjes, djegies, terrorit dhe vrasjes e civilëve shqiptarë. Në krye të këtij aksioni ishin komandanti i policisë së Lipjanit, Stevan Raxhenoviq, i lindur në Rufcin e Ri, nënkryetari i dhunshëm i komunës së Lipjanit, Sllavisha Dukiqi, i lindur në Magurë, Millosh Toshqi, që ishte polic në Lipjan, pastaj Dragan Dejanoviqi nga Lipjani, që ishte inspektor dhe të tjerë serbë lokalë, që ishin të armatosur dhe zbatonin urdhrat e ushtrisë dhe policisë serbe. Në këtë grup ishin edhe Vukadin Millosheviqi, nga Rufci i Ri, Millka Romiqi dhe djali i saj Dragan Romiqi, Banisllav Llabusi nga Lipjani etj.¹⁶

Në këtë aksion u vranë dhe u masakruan 25 banorë civilë shqiptarë, prej të cilëve 19 ishin banorë të këtij fshati, ndërsa 6 të tjerë ishin anëtarë të familjes Vuniqi nga fshati Vërshec (tani Blinajë), që ishin strehuar aty.¹⁷ Në këtë fshat nuk kishte rezistencë të armatosur, që t'i nxiste forcat serbe për hakmarrje në popullsinë civile. Forcat serbe vranë dhe masakruan civilët shqiptarë nëpër shtëpitë dhe oborret e tyre. Pesë ditë pas kryerjes së krimit, banorët e kthyer të fshatit kanë varrosur trupat e 26 shqiptarëve* të vrarë në

¹⁵ *Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999*, 917-922; Tasholli, *Lipjani me rrethinë*, 323-324.

¹⁶ Tasholli, *Lipjani me rrethinë*, 325; Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lypjanit*, 20.

¹⁷ Ali Ukaj, *"Masakra e Ribarit (1999)"*, Fjalori Enciklopedik i Kosovës, Volumi II, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2018, 1059.

* Është varrosur edhe kufoma e djegur në shtëpinë e tij të Sali Fetahut (35) nga fshati Rufci i Ri i komunës së Lipjanit.

varrezat e fshatit. Por, fatkeqësisht trupat e tyre janë zhvarrosur dhe rivarrosur nga forcat serbe më 31 maj 1999, me arsyetimin për t'i identifikuar ekspertët serbë. Pas përfundimit të luftës, me ardhjen e hetuesve të Tribunalit të Hagës, trupat e civilëve të masakruar shqiptarë, janë nxjerrë, identifikuar dhe për të tretën herë janë rivarrosur.¹⁸ Dhe sigurisht një proces i tillë ka pasur ndikim psikosocial e emocional te familjarët e të vrarëve. Pra, lirisht mund të konstatojmë se kujtesa dhe ballafaqimi me atë çfarë ka ndodhur në këtë masakër ka qenë i vazhdueshëm dhe me pasoja afatgjate, gjë që flet për një segment tjetër të dhimbjes.

Lista e emrave të civilëve të vrarë në Masakrën e Ribarit të Vogël

Nr.	Emri dhe mbiemri	Viti i lindjes	Vendlindja	Gjinia	Mosha e viktimës
1.	Qazim Asllan Vishesella	1942	Ribar i Vogël	Mashkull	57-vjeçar
2.	Selim Asllan Vishesella	1947	Ribar i Vogël	Mashkull	52-vjeçar
3.	Miradije Selim Vishesella	1985	Ribar i Vogël	Femër	14-vjeçar
4.	Fatime Isuf Vishesella	1953	Ribar i Vogël	Femër	46-vjeçare
5.	Rexhep Asllan Vishesella	1950	Ribar i Vogël	Mashkull	49-vjeçar
6.	Kreshnik Rexhep Vishesella	1982	Ribar i Vogël	Mashkull	17-vjeçar
7.	Ismet Rexhep Vishesella	1985	Ribar i Vogël	Mashkull	14-vjeçar
8.	Hajdar Ibrahim Vishesella	1929	Ribar i Vogël	Mashkull	70-vjeçar

¹⁸ Tasholli, *Lipjani me rrethinë*, 326.

9.	Mihane Baca Vishesella	1922	Ribar i Vogël	Femër	77-vjeçare
10.	Dafina Bajram Vishesella	1992	Ribar i Vogël	Femër	7-vjeçare
11.	Mehmet Mehmet Vuniqi	1941	Vërshevc	Mashkull	58-vjeçar
12.	Kemajl Mehmet Vuniqi	1969	Vërshevc	Mashkull	30-vjeçar
13.	Ganimete Mehmet Vuniqi	1977	Vërshevc	Femër	22-vjeçare
14.	Izet Ajë Vuniqi	1945	Vërshevc	Mashkull	54-vjeçar
15.	Irfan Izet Vuniqi	1982	Vërshevc	Mashkull	17-vjeçar
16.	Mirsade Izet Vuniqi	1983	Vërshevc	Femër	16-vjeçare
17.	Ismajl Adem Gërxhaliu	1941	Ribar i Vogël	Mashkull	58-vjeçar
18.	Sali Hysen Gërxhaliu	1936	Ribar i Vogël	Mashkull	63-vjeçar
19.	Hashim Shaban Gërxhaliu	1948	Ribar i Vogël	Mashkull	51-vjeçar
20.	Hasime Adem Gërxhaliu	1951	Ribar i Vogël	Femër	48-vjeçare
21.	Hasan Shaban Ismajli	1938	Ribar i Vogël	Mashkull	61-vjeçar
22.	Jashar Rifat Jashanica	1942	Ribar i Vogël	Mashkull	57-vjeçar
23.	Muhamet Sylejman Kelmendi	1962	Ribar i Vogël	Mashkull	37-vjeçar
24.	Selime Ismajli	1948	Ribar i Vogël	Femër	51-vjeçare

25.	Riza Osman Jashanica	1902	Ribar i Vogël	Mashkull	97-vjeçar
-----	-------------------------	------	---------------	----------	-----------

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme vërejmë që sa i përket strukturës gjinore të të vrarëve, nga 25 të ekzekutuarit, 17 prej tyre ishin meshkuj dhe 8 femra, ndërsa sa i përket moshës së viktimave ata ishin nga 7 deri në 97 vjeçar.¹⁹ Po ashtu 7 qytetarë të tjerë shqiptarë i gjymtuan me plagë të rënda, pa dallim moshe a gjinie. Në pothuajse të gjitha rastet e masakrave, vërejmë lehtësisht se vrasjet, dhuna e maltretimeve nuk kanë pasur në fokus vetëm një shtresë, gjini apo moshë të caktuar. Pra, një gjë e tillë nuk ka qenë fare problem përballë një regjimi, i cili në rastin konkret nuk ka zgjedhur mjete, për ta realizuar qëllimin e tij definitiv, frikësimin, poshtërimin, eliminimin dhe dëbimin definitiv të shqiptarëve nga trevat e tyre. Duhet të shtohet fakti se në ofensivën e forcave serbe në Ribar të Vogël, krahas vrasjes dhe masakrimit të 25-civilëve shqiptarë, janë plagosur edhe këta civilë:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Viti i lindjes	Vendlindja	Gjinia	Mosha e viktimës
1.	Nazif Ismajli	1917	Ribar i Vogël	Mashkull	82-vjeçar
2.	Hyrfete Ismajli	1921	Ribar i Vogël	Femër	78-vjeçare
3.	Afrim Fetahu	1975	Ribar i Vogël	Mashkull	24-vjeçar
4.	Ramiz Jashanica	1969	Ribar i Vogël	Mashkull	30-vjeçar ²⁰

Gjatë kësaj ofensive, është plagosur dhe më pas, jo larg nga ai moment ka vdekur edhe zonja Jalldyze Ismajli 52-vjeçare. Për masakrën në Ribar të Ri, japin dëshmitë e tyre qytetarë të cilët ishin prezentë, si: Nazmi

¹⁹ Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lypjanit*, 19.

²⁰ *Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999*, 923-926; Tasholli, *Lipjani me rrethinë*, 325-326.

Vishesella, sipas të cilit forcat serbe kanë hyrë nëpër shtëpitë e qytetarëve shqiptarë dhe i kanë vrarë shumë prej tyre.

Sipas këtij dëshmitari vetëm në oborrin e familjes Vishesella janë vrarë 10 anëtarë të kësaj familje dhe 6 qytetarë të zhvendosur nga Vërshevc. Prej 16 viktimave, 6 ishin të gjinisë femërore, duke përfshirë këtu edhe fëmijë të moshës 6-vjeçare.²¹ Një rrëfim për krimet serbe në këtë fshat e jep edhe dëshmitari Kushtrim Vishesella, në prani të të cilit ushtria dhe policia serbe i ekzekutuan dy prindërit dhe motrën e tij. Sipas dëshmitarëve, të ekzekutuarit zakonisht si fillim janë plaçkitur, më pas janë rrahur e maltretuar dhe në fund janë ekzekutuar. E plagosura, por që u mbijetoi plagëve Shemsie Vishesella tregon për tmerret e përjetuara në ditën e ekzekutimit të burrit dhe dy djemve të saj. *“Pasi që ushtria dhe policia serbe kishin hyrë në shtëpi, kërkuan nga ne para dhe gjësende me vlerë dhe më pas na detyruan të shtriheshim në tokë, ku nga automatikët janë ekzekutuar në afërsi burri dhe djemtë, ndërsa unë kam mbetur e plagosur”*.²²

Forcat serbe pas krimeve të kryera ndaj popullsisë civile në Ribar të Ri, kanë tentuar të fshehin veprimet e tyre (negacionizmi), veprim që hynë në kategorinë e dhjetë të gjenocidit, andaj si i tillë dënohet me ligjet ndërkombëtare. Dëshmitari Mehdi Vishesella ndër të tjera thotë: *“kriminelët serbë, pasi i kishin vrarë, për t'i humbur gjurmët e krimit, babën dhe Dafinën i kishin hedhur në një kanal pranë shtëpisë së Rexhep Sejdiut dhe i kishin mbuluar me dhe, pastaj i kishin shkelur me autoblanda...”*.²³ Krahas masakrave ndaj popullsisë civile shqiptare, forcat serbe dogjën afërsisht gjysmën e fshatit dhe u realizuan një sërë veprimesh të dëmshme ndaj pronës familjare dhe ekonomike. Prandaj pasojat ishin jo vetëm të atypëratyshme, por edhe të mëpastajme, ngase me përfundimin e luftës, u nevojiten investime nga zero, për rimëkëmbjen e gjithçkaje që ishte shkatërruar.

Masakra e Hallaqit të Vogël

Më 19 prill 1999 në fshatin Hallaç i Vogël të komunës së Lipjanit pas një aksioni të forcave ushtarake dhe policore serbe u ekzekutuan dhe u masakruan 20 banorë civilë shqiptarë të këtij fshati, të moshës prej 19 - 75-

²¹ Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lypjanit, 1912-1999*, 22-27.

²² Po aty, 49-53.

²³ Po aty, 56.

vjeçar, nga të cilët tre ishin nga vendbanime të tjera.²⁴

Forcat serbe urdhëruan burra, gra, fëmijë e pleq shqiptarë të këtij fshati të tubohen në lëndinën e fshatit. Qytetarët e mbledhur në mes të fshatit, u dorëzuan dhe më pasë u plaçkitën dhe në mesin e tyre i morën 50 meshkuj, por për ekzekutim mbetën vetëm 13 persona të moshës së mesme. Prej tyre 11 u ekzekutuan para syve të familjarëve, pas komandës “veproni sipas urdhrit”, forcat serbe shkrepën tërë arsenalin e tyre mbi trupat e mbështetur për muri, të civilëve shqiptarë. Nga breshëria e plumbave, shpëtuan Idriz Govori dhe Beqir N. Asllani (i plagosur), të mbetur nën trupat e personave të vrarë.²⁵ Të plagosurit nga vendi i ekzekutimit u dërguan nga familjarët në fshatin Krojmir të Lipjanit, ku u mjekuan nga mjekët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.²⁶ Aty ku tash është lapidari është hapur një varr masiv ku janë varrosur të gjithë shqiptarët e vrarë.

Dhjetë ditë pas vrasjes së tyre, policia e Lipjanit kishte urdhëruar zhvarrosjen e kufomave, të cilat pasi u ngarkuan në një kamion, u dërguan në burgun e Lipjanit, ku është bërë identifikimi nga “ekspertët e mjekësisë ligjore” dhe më pas u lejua rivarrimi i tyre, por nën mbikëqyrjen e policisë serbe. Pas 3-4 muajve, konkretisht pas çlirimit të Kosovës, erdhën ekspertët e Tribunalit të Hagës, të cilët i nxorën kufomat dhe bënë ekspertizën e vërtetë, duke i marrë të gjitha shënimet e nevojshme. Pas kryerjes së ekspertizës, u bë rivarrimi i tretë i kufomave të civilëve shqiptarë të vrarë në Hallaq të Vogël.²⁷ Po ashtu, në këtë fshat në shtëpitë e tyre u vranë dhe u masakruan edhe 9 qytetarë të tjerë shqiptarë, të cilët nuk u larguan nga shtëpitë. Dy prej trupave të viktimave ishin të karbonizuara, pasi forcat serbe dogjën shtëpitë e tyre. Krahmas masakrës ndaj civilëve shqiptarë, ushtria dhe policia serbe dogji 37 shtëpi (ose 60%) dhe shumë të tjera u shkatërruan dhe u plaçkitën. Sa i përket aspektit gjinor, vetëm një nga viktimat e ekzekutuara është femër, ndërsa sa i përket moshës së viktimave ajo varionte nga 19 deri në 75-vjeçare.²⁸

²⁴ Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë, 1998-1999*, 502; Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lypjanit*, 76.

²⁵ Tasholli, *Lipjani me rrethinë*, 326-327; *Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999*, 910 dhe 927; Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lypjanit*, 76.

²⁶ Ali Ukaj, “*Masakra e Hallaqit (1999)*”, Fjalori Enciklopedik i Kosovës, Volumi II, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2018, 1055.

²⁷ Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lypjanit*, 80-81.

²⁸ Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lypjanit*, 76-77.

Lista e emrave të civilëve të vrarë në Masakrën e Hallaqit të Vogël

Nr.	Emri dhe mbiemri	Viti i lindjes	Vendlindja	Gjinia	Mosha e viktimës
1.	Minush Demir Gashi	1923	Hallaq i Vogël	Mashkull	77-vjeçar
2.	Ejup Demir Gashi	1940	Hallaq i Vogël	Mashkull	59-vjeçar
3.	Demir Minush Gashi	1957	Hallaq i Vogël	Mashkull	42-vjeçar
4.	Avdulla Daut Gashi	1970	Hallaq i Vogël	Mashkull	29-vjeçar
5.	Rexhep Azem Buzuku	1924	Hallaq i Vogël	Mashkull	75-vjeçar
6.	Nuhi Rexhep Buzuku	1956	Hallaq i Vogël	Mashkull	43-vjeçar
7.	Zeqir Zahir Buzuku	1953	Hallaq i Vogël	Mashkull	46-vjeçar
8.	Nadire Zeqir Buzuku	1980	Hallaq i Vogël	Femër	19-vjeçare
9.	Muharrem Hazir Asllani	1957	Hallaq i Vogël	Mashkull	44-vjeçar
10.	Nazim Hazir Asllani	1969	Hallaq i Vogël	Mashkull	30-vjeçar
11.	Milazim Zymer Zeka	1962	Hallaq i Vogël	Mashkull	37-vjeçar

12.	Avdi Zymer Zeka	1964	Hallaq i Vogël	Mashkull	35-vjeçar
13.	Sami Zymer Zeka	1976	Hallaq i Vogël	Mashkull	23-vjeçar
14.	Ragip Osman Jashari	1961	Hallaq i Vogël	Mashkull	38-vjeçar
15.	Fehmi Hasim Aliu	1973	Hallaq i Vogël	Mashkull	26-vjeçar
16	Isa Sefë Govori	1959	Hallaq i Vogël	Mashkull	40-vjeçar
17.	Nezhmedin Nazmi Fazliu	1966	Hallaq i Vogël	Mashkull	33-vjeçar
18.	Enver Mulaku	1956	Vushtrri	Mashkull	43-vjeçar
29.	Ekrem Faik Bajrami	1976	Zborc-Shtime	Mashkull	23-vjeçar
20.	Selim Rrahim Selimi	1969	Shalë	Mashkull	39-vjeçar ²⁹

Gjatë aksionit të tyre forcat serbe kanë vrarë edhe qytetarë të tjerë shqiptarë. Kështu, kur u detyruan qytetarët të braktisnin shtëpitë e tyre dhe të niseshin në drejtim të Shqipërisë apo të Maqedonisë, forcat serbe e ndalën 31-vjeçarin Sali Statovci dhe pasi e dërguan në shtëpinë e tij, e ekzekutuan dhe më pas e kanë djegur kufomën e tij. Sipas dëshmitarit dr. Enver Kelmendi, pas 3-4 ditësh të kërkimit të Saliut, nën gërmadhat e shtëpisë janë gjetur vetëm 2-3 unaza të boshtit kurrizor dhe gjysma e kafkës së kokës, të cilat janë varrosur në varrezat e Ribarit të Vogël, së bashku me kufomat e tjera.³⁰ Dëshmitari Daut Kelmendi ndër të tjera thotë që: “në krye të forcave

²⁹ Po aty, 82; *Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999*, 927-932.

³⁰ Po aty, 33.

ushtarake e policore serbe, që kryen krimet në Ribar të Vogël dhe në Hallaq të Vogël ishte ish-komandanti i forcave serbe i njohur me nofkën “Musa”. Por, Idriz S. Govori dhe Beqir N. Asllani janë dëshmitarët okularë të cilët i mbijetuan ekzekutimit nga forcat serbe, ngase prej 13 të ekzekutuarve këta dy mbijetuan. Sipas këtyre dëshmitarëve, të gjitha viktimat janë ekzekutuar me automatik nga afër dhe kryesisht në kokë dhe gjoks. Së pari kontrolloheshin dhe merrnin nga qytetarët civilë shqiptarë të gjitha gjësendet që kishin me vete, duke përfshirë edhe dokumentet e identifikimit dhe më pas i ekzekutonin.³¹

Në komunën e Lipjanit, krahas vrasjeve dhe masakrave masive në fshatrat e sipërshtënuara, edhe në fshatrat e tjera të kësaj komune gjatë viteve 1998-1999 janë vrarë dhe masakruar qytetarë shqiptarë, si: në Kraishtë (11 persona), Ribar i Madh (7 persona), Blinajë (ish-fshati Vërshec, 8 persona), Mirenë (7 persona), Kleçkë (2 persona), Shalë (5 persona), Krojmir (2 persona), Baicë (3 persona), Resinoc (5 persona), Zllakuqan (1 person), Bregu i Zi (1 person), Leletiq (1 person), Jeta e Re (1 person), Varigoc (1 person), Akllap (1 person), Terbuvc (1 person*), Gadime e Ulët dhe e Epërme (3 persona), Vrellë (2 persona*) Babush i Muhaxhirëve (2 persona), Konjuh (1 person), Plitkoviç (1 person*), Janjeva (1 person), Brusi (2 persona), Shashkovci dhe Shushica (7 persona), Hanrovci (7 persona), Bukovik (2 persona) dhe Fushticë (2 persona). Gjithsej 87 civilë të ekzekutuar. Në territorin e komunës së Lipjanit janë vrarë 15 civilë nga vendbanimet e tjera të Kosovës. Për detaje në lidhje me vrasjen e tyre dhe strukturën gjinore dhe moshën, si dhe vendin ku janë ekzekutuar, po japim të dhëna tabelore:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Viti i lindjes	Vendlindja	Gjinia	Vendi i ekzekutimit
1.	Rabishe Mulaku	1976	Komoran-Drenas	Femër	Gryka e Shalës
2.	Besim Osmani	1977	Fushticë-	Mashkull	Resinoc

³¹ *Po aty*, 41, 83-90.

* Në këtë fshat vritet Zylfije Faik Gashi (20-vjeçare), ndërsa plagoset vajza e mitur Shqipe Mehmedali Gashi. Shih në: Tasholli, *Lipjani me rrethinë*, 324.

* Në Vrellë të Gadimes vriten Adil Oruçi (80-vjeçar) dhe Arife Oruçi (75-vjeçare), nga Bresalci i Gjilanit. Shih në: Tasholli, *Lipjani me rrethinë*, 2020, 324.

* Në këtë fshat vritet Murat Kelmendi (70-vjeçar). Shih në: Tasholli, *Lipjani me rrethinë*, 324.

			Drenas		
3.	Hajrije Osmani	1947	Fushticë-Drenas	Femër	Resinovc
4.	Afrim Ismet Latifi	1966	Carralejë-Shtime	Mashkull	Varigovc
5.	Arsim Ismet Latifi	1974	Carralejë-Shtime	Mashkull	Varigovc
6.	Bekim Jakup Haziri	1980	Prishtinë	Mashkull	Silovi
7.	Raif Maliq Shala	1948	Shushicë-Istog	Mashkull	Silovi
8.	Enver Mulaku	1962	Vushtrri	Mashkull	Hallaq i Vogël
9.	Ekrem F. Bajrami	1976	Zborc-Shtime	Mashkull	Hallaq i Vogël
10.	Ibrahim Ramiz Beqiri	1975	Vërbicë-Gjilan	Mashkull	Smallushë
11.	Adil Oruqi	1919	Bresalc-Gjilan	Mashkull	Vrellë-Gadime
12.	Arife Oruqi	1924	Bresalc-Gjilan	Femër	Vrellë-Gadime
13.	Miradije Lubovci	1924	Shtime	Femër	Bregu i Zi
14.	Fazli Gashi	1946	Prishtinë	Mashkull	Hanrovç
15.	Naim Gashi	1981	Prishtinë	Mashkull	Hanrovç ³²

Vlen të përmendet se përgjegjës për krimet e kryera, sipas dokumenteve ishin të involvuar drejtpërdrejt edhe kryetari i Qarkut të Kosovës, Velko Odalloviq, me vartësit komunalë të Lipjanit, njëri ndër ta Lubinko Bozhiq. Në komunën e Lipjanit Sllavisha Dukiq ishte përgjegjës

³² Tasholli, *Lipjani me rrethinë*, 329.

për drejtimin e njësiteve të policisë dhe të ushtrisë.³³ Por, dyshohet se udhëheqësi kryesor i të gjitha grupeve për krimet në komunën e Lipjanit ishte Nikolla Iliqi, kryeshf i stacionit të policisë në Lipjan.³⁴ Krahës qindra civilëve të vrarë e ekzekutuar, në komunën e Lipjanit nga dhuna serbe u zhvendosën tërësisht banorët shqiptarë të 42 fshatrave, kurse pjesërisht nga 21 fshatra të tjera. U përfshinë nga zjarri 46 vendbanime shqiptare të kësaj treve. Në ofensivën e parë korrik-tetor 1998 u përfshinë 14 fshatra të komunës së Lipjanit. Në këtë ofensivë tërësisht u dogjën tri fshatra: Blinaja 120 shtëpi, Baica e Kolshit 67 shtëpi dhe Leletiqi 46 shtëpi. Ndërsa dëmtime të mëdha nga djegiet, shkatërrimet dhe plaçkitjet, pësuan: Shala 127 shtëpi, Resinoci 16 shtëpi, Krojmiri 5 shtëpi, Magura 38 shtëpi, Mirena 3 shtëpi, Qylaga 8 shtëpi dhe Poturoci 2 mullinj elektrikë.

Pra, nga kjo ofensivë u dëmtuan 463 shtëpi dhe dy mullinj elektrikë. Gjatë prillit të vitit 1999, ushtria dhe policia serbe dogjën dhe shkatërruan edhe fshatrat e rrafshit përreth Lipjanit, si: Konjuhin, Rufcin e Ri, Topliqanin, Hallaqin e Madh dhe Grackën e Vjetër*. Për pasojë tri fshatra mbetën të pabanueshme deri në qershor 1999, ngase nga fshatrat e sipërshtënuara u dëbuan mbi 25 000 qytetarë shqiptarë. Dëmet ishin të mëdha edhe për sa i përket humbjeve njerëzore. Kështu, në trevën e komunës së Lipjanit në këtë ofensivë humbën jetën gjithsej 33 qytetarë civilë shqiptarë, prej të cilëve 4 u shpallën dëshmorë, ndërsa 14 të rënë në këtë rajon, ishin nga komunat e tjera. Po ashtu gjatë kësaj ofensive sipas të dhënave të KMDLNJ-së u plagosën 51 qytetarë civilë shqiptarë, ndërsa u arrestuan 24 të tjerë.

Më 20 e 21 mars 1999, në Lipjan zbarkuan disa kompozicione trenash me armatim të rëndë e njësi ushtarake e policore. Zyrtarët serbë paralajmëruan popullatën shqiptare për një kundërveprim ndaj tyre, në përgjigje të sulmeve të NATO-s. Qeveria serbe shpalli gjendje lufte, e Maqedonia mbylli përkohësisht kufirin për shqiptarët. Ky sistem forcash ushtarake e policore, të ndihmuara nga udhëheqësit dhe popullata vendore serbe u sistemua dhe u vendosën nëpër pika qendrore të vendbanimeve serbe dhe disa pikave të tjera në mjediset etnike shqiptare. Kështu, njësitë ushtarake me armatim të rëndë u vendosën në Lipjan, te Kooperativa Bujqësore, në shkollën e mesme (sot Gjymnazi “Ulpiana”), në objektet e

³³ Bajrami, *Lufta kundër luftës në Kosovë*, 164-166.

³⁴ Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lipjanit*, 20.

* Gjatë ofensivës së zhvilluar nga forcat serbe, në këto fshatra, në muajin prill, forcat serbe e vranë dhe e dogjën plakun 68-vjetar, Xhevat Rexhepin, Grackë e Re, Gllogoc. Shih në: Xhemajl Berisha, *Zhvillimet politike-sociale në Lipjan gjatë viteve 1997-1999*, (Tezë masteri), (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2018).

Fabrikës së Ventilatorëve dhe Fabrikës së Letrës, në Fermën e Shpendarisë etj. Morën pozicione në Magurë, në Blinajë, në Kodër të Goleshit, në Vrellë, në Medvec afër aeroportit të Sllatinës, në Grackë të Vjetër, në Slllovi, në Smallush dhe në Babush të Muhaxhirëve.

Po ashtu, forca ushtarake e policore kishte kudo nëpër fshatrat etnike serbe: në Suhadoll, Lepinë, Skullan e Radevë, në Dobratin, Gushtericë të Poshtme e të Epërme dhe në Livaxhë. Sulmet e ushtrisë dhe policisë serbe nuk ishin drejtuar në luftë me forcat e armatosura të UÇK-së në krahun e Drenicës së Epërme, e as në zonën e Bjeshkëve të Zhegocit, por drejt popullsisë civile, gjithnjë për të arritur më lehtë qëllimin e ndjekjes së shqiptarëve. Më 28 mars 1999 forcat serbe sulmuan fshatin Babush i Muhaxhirëve dhe aty vranë dy e plagosën tre qytetarë shqiptarë, ndërsa e shpërngulen me dhunë popullatën shqiptare nga ky fshat dhe nga Gadimja e Poshtme. Po më 15 prill 1999, forcat ushtarake e policore serbe sulmuan edhe Smallushën, dogjën mbi 40 shtëpi dhe dëbuan nga shtëpitë e tyre gjithë popullatën shqiptare.

Më 16 prill u shpërngulen me dhunë qytetarët shqiptarë të fshatit Vrellë të Gadimës dhe u dogjën të gjitha shtëpitë. Nga Gadimja e Epërme u dëbuan afro 20 000 qytetarë që ishin strehuar edhe nga fshatrat e tjera dhe në një kolonë nën përcjelljen e forcave policore serbe u dëbuan për në Shqipëri. Sa u përket dëbimeve dhe abuzimeve mbi shqiptarët në komunën e Lipjanit, na jep të dhëna me mjaft vlerë një përmbledhje që i është bërë një raporti të nxjerrë nga Human Right Watch, i realizuar në tetot të vitit 2001, sipas të cilit komuna e Lipjanit (Lipljan) sikurse ishte edhe ajo e Pejës, kishte një numër të konsiderueshëm të popullsisë serbe dhe për dallim nga zonat e tjera ku lufta ishte më e ashpër, si: Drenicë, Gjakovë, Suharekë etj., që ishin zona më të thella lufte, komuna e Lipjanit ishte piketuar për shpërngulje masive të shqiptarëve etnikë, ndërsa vrasjet ishin më të lokalizuara në fshatra të tilla, si në Slllovi (Slovinje), Ribar (Ribar). Megjithëse, gjatë vitit 1998 dhe fillimvitit 1999, UÇK-ja ishte aktive në pjesën më të madhe të komunës perëndimore të Lipjanit. Sipas këtij raporti, ka pak apo aspak fakte për të bërë lidhjen e UÇK-së me disa nga fshatrat ku ndodhën masakrat. Sipas tij, vrasjet ishin pasojë e një plani më të gjerë operacionesh për të terrorizuar popullsinë që të largohej nga Kosova, duke përdorur ushtrinë, policinë dhe forcat paramilitare serbe. Vrasjet e qëllimshme dhe të paligjshme të civilëve dhe ekzekutimet pa gjyq, ishin një pjesë e rëndësishme e fushatës “së spastrimeve”.³⁵ Në krahun lindor të Lipjanit, ku hynë Janjeva (me vetëm një të vrarë) me rrethinë, ka pasur më

³⁵ Human Right Watch, NËN URDHËRA: Krimet e luftës në Kosovë, 2001; marrë nga: <https://www.hrw.org/legacy/albanian/kosovo2001/summary.pdf> (15/12/2020)

pak të vrarë. Gjithashtu në këtë pjesë edhe dëmet e shkaktuara nga ushtria serbe kanë qenë më të vogla. Megjithatë, banorët e Janjevës dhe rrethinës u detyruan që të shpërnguleshin nga vendbanimet e tyre. Ndërkohë, sa u përket të vrarëve, siç mund ta vëreni të specifikuar edhe në faqe 17 të këtij studimi (Human Right Watch), shqiptarët e vrarë janë: 1 nga Janjeva, 2 nga Brusi, 7 nga Shashkovci dhe Shushica dhe 7 nga Hanrovci. Shqiptarët janë dëbuar nga shtëpitë e tyre në fshatrat: Brusi, Hanrovc, Bukovicë e Vokoqincë etj.³⁶

Klasifikimi i të vrarëve sipas profesionit, gjinisë dhe statusit të tyre social

Në komunën e Lipjanit të vrarët dhe të ekzekutuarit civilë shqiptarë kishin këtë status social: nxënës 21, studentë 3, arsimtarë 2, të papunë 48, pensionistë 3, pleq 16, amvise 18, minatorë 11, të sëmurë 4, bujq 2, vajza 1, punëtorë 23, inxhinierë 1, elektrikist 1, shofer 1, afaristë 2, tregtar 1, profesor 1 dhe të padefinuar 6. Gjithsej janë 167 të vrarë. Gjashtë të padefinuarit për profesionin, janë persona nga komunat tjera, që ato ditë ishin të strehuar në vendbanimet e komunës së Lipjanit. Sa i përket numrit të të vrarëve sipas moshës, gjendja është kështu: 2 fëmijë 0 - 7-vjeçar, 6 fëmijë 8 - 14-vjeçar, 11 fëmijë 15 - 18-vjeçar, 105 të rritur 19 - 60-vjeçar dhe mbi moshën 60-vjeçare 34.³⁷ Jo vetëm në këtë komunë, por në të gjitha viset e Kosovës, u vranë civilë, të cilët dihej mirë që nuk ishin luftëtarë dhe ndër të cilët kishte shumë gra dhe fëmijë.³⁸ Duhet të theksohet fakti se për krimet e kryera nga forcat ushtarake dhe policore serbe në komunën e Lipjanit, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNJ) me seli në Prishtinë, më 25 mars 2002 ka bërë një kallëzim penal ndaj 21 personave serbë*, të cilët kanë kryer krimet në këtë komunë, ndërsa ishin në strukturat më të larta të policisë dhe të Kuvendit Komunal të

³⁶ Xhemajl Berisha, *Zhvillimet politike-sociale në Lipjan gjatë viteve 1997-1999*, (Tezë masteri), (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2018), 29.

³⁷ *Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999*, 907.

³⁸ Human Right Watch, NËN URDHËRA: Krimet e luftës në Kosovë, 2001; marrë nga: <https://www.hrw.org/legacy/albanian/kosovo2001/summary.pdf> (15/12/2020)

* Emrat e kriminelëve serbë janë: Nikolla (Bllazho) Iliq, Tomisllav Stanishiq (Tomiqi), Zllatibot Miodrag Laiq, Svetisllav Miliana Sojanoviq, Momir Dragolub Jevtiq, Cvetko (Marko) Todoroviq, Millosh (Miodrag) Toshq, Stevan (Gjuro) Ragienoviq, Milivoje Pejqi, Sllavisha Dukiq, Vukadin Millosheviq (Vule), Radomir Arsiq, Stanoje Milkiq, Slllobodan Simiq, Dragan Dejanoviq, Dragan Igiq, Dragan Romiq, Millka Romiq, Branisllav Llabus, Sllavisha Dukiq dhe Sava Markoviq. Për më tepër shih në: Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lypjanit*, 108-109.

Lipjanit. Nëpërmjet këtij kallëzimi, KMDLNJ kërkonte nga Tribunali Ndërkombëtar për Krime të Luftës, të kryera në territorin e ish-RSFJ-së, që konform autorizimeve të veta ligjore, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me këtë kallëzim penal.³⁹

Bazuar në të dhënat e mësipërme, të cilat janë specifike, vërehet qartë plani, operacioni dhe qëllimi i Serbisë në Kosovë në përgjithësi dhe në komunën e Lipjanit në veçanti. Dëshmi për këtë janë statistikave të ofruara mbi njerëzit e ekzekutuar dhe pasurinë ekonomike familjare të shkatërruar si dhe dëbimin e banorëve nga vendbanimet e tyre. Përtej këtyre fakteve të pamohueshme, me qëllim të arritjes së efektit real shkencor, vlerësojmë se është i nevojshëm një studim edhe më i thellë, me qëllim nxjerrjen e statistikave që janë lehtë të verifikueshme, duke përfshirë këtu edhe intervistimin e një numri më të madh njerëzish që kanë përjetuar gjithë çfarë ka ndodhur në komunën e Lipjanit. Kjo është me shumë rëndësi edhe për faktin se në burimet e përdorura, në disa raste janë vërejtur shpërputhje në ofrimin e të dhënave mbi numrin e njerëzve të ekzekutuar apo kategorive të tjera. Prandaj, këto të dhëna mund t'i konsiderojmë vetëm një fazë ose bazë solide të tyre, të cilat duhet mbyllur me një studim definitiv dhe më të plotë të mëpastajmë, si fazë e dytë dhe përmbyllëse e projektit.

³⁹ Ukaj, *Krimet serbe në komunën e Lipjanit*, 107-120.